

VENDIM
Nr.254, datë 22.6.1992

**PËR NDRYSHIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE POSTARE DHE TË
TELEKOMUNIKACIONIT**

Me propozim të Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë dhe të Ministrisë së Transportit e Komunikacionit, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Tarifat e shërbimeve postare edhe të telekomunikacionit rriten ndaj atyre ekzistuese, në kufijtë përkatësisht si vijon:

	Për popullin	Për përdosuesit e tjerë
a) Tarifat e shërbimeve postare	2 herë	3.5 herë
b) Tarifat e shërbimeve të telekomunikacionit	2 herë	1.5 herë

2. Tarifat e mëparshme për shërbimin postar dhe të telekomunikacionit, shfuqizohen.
Ky vendim hyn në fuqi më 1 korrik 1992.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi